

Center Coll 2320 e bardhë

- ◆ Koll akrilike me performancë të lartë, pa rrëshqitshmëri vertikale dhe kohë të gjatë hapjeje. Përbëhet nga inerte mermeri me kurbe granulometrike rigorozë, çimento portland 52.5R, rezina akrilike dhe aditiv special.
- ◆ Veçanërishtë e përshtatme për ngjitjen e pllakave prej mermeri, graniti, apo çdo lloj guri natyral. Mund të përdoret dhe për pllaka gres, porcelan apo qeramike. I përshtatshëm për shtrimin e pllakave në fasada, banjo, pishina, dysheme subjekt të trafikut të vazhdueshëm dhe vendosjen e pllakës mbi pllakë. Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.
- ◆ Për një aplikim sa më të mirë rekomandohet që fillimisht shtrimi i produktit mbi suport të bëhet me pjesën e drejtë të mallës, e më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Rekomandohet që pas vendosjes së pllakës të ushtrohet presion mbi të në mënyrë që pjesa e pasme të laget plotësisht. Mbushja e fugave të pllakave mund të realizohet pas 24- 36 orësh. Në varësi të gjerësisë dhe trashësisë së shtresës, këshillohet: CENTER STUKO 0-8 mm për mbushjen e veshjeve me fuga më të vogla se 8 mm. Suportet ku do të aplikohet produkti duhet të jenë të pastra nga lëndët e huaja.

Përgatitja.

Në një enë hidhni 7 - 8 litra ujë dhe 25 kg produkt. Përzjeni me një përzjerës elektrik me numër të vogël rotullimesh derisa masa të bëhet homogjene pa kokriza dhe me viskozitetin e dëshiruar. Rekomandohet që përzjerja të lihet në qetësi rreth 10 minuta dhe të përzjehet përsëri përpara përdorimit.

Të Dhënat Teknike

◆ Raporti i Përzieries	7 - 8 litra ujë/25kg
◆ Jetëgjatësia e llaçit	4 orë
◆ Temperatura e aplikimit	+5 deri +35 °C
◆ Ngjyra	E bardhe
◆ Koha e hapjes	30 min
◆ Koha e Korrigjimit	45 min
◆ Konsumi	5 - 6 kg/m ²
◆ Forma	Pluhur
◆ Paketimi	Thase 25kg
◆ Ruajtja	6 muaj nga data e prodhimit

Forca e Ngjitjes

◆ Pas zhytjes në uje	≥ 1 N/mm ²
◆ Pas cikleve ne ngrirje shkrires	≥ 1 N/mm ²
◆ Pas Veprimit të nxehtësisë	≥ 1 N/mm ²
◆ Në kushte normale	≥ 1 N/mm ²
◆ Deformueshmëria	≥ 3,7 mm

